



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1888/ 3 prot.,

Datë 02.08.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-69747-05-19-2023, me objekt “*Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)*”, me fond limit 379,248,000 (*treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK
Adresa: Rruga “Asim Vokshi”, Alb building 2T, Kt. 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 33, Tiranë.

Në datën 01.08.2023 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër elektronik A/2023/3330, datë 01.08.2023 dhe me nr. 1888 prot, datë 01.08.2023 e operatorit ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-69747-05-19-2023, me objekt “*Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)*”, me fond limit 379,248,000 (*treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1888 prot., datë 01.08.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

2. *Operatori ekonomik “Alko Impex Construction” nuk kualifikohet, pasi nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat standarte te tenderit.*

**Nuk përmbush kapacitetet teknike pika 2.3.4 dhe pika 2.3.5 perkatesisht disponimi I stafit kryesor , stafi mbeshtetes. Stafi i deklaruar ne kete procedure eshte i angazhuar ne nje kontrate tjeter.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 02.08.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri